

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Sistemim asfaltim rruga Bel-Unjate L= 4500m, rruga Gurrë e Madhe-Mishtër L= 1425m, rruga Fullqet lagje Rata-Dardha L= 1580m”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Ndërtim, themele dhe punime terreni për autostrada, rrugë 45233000-9.

VLERA E FONDIT LIMIT: 90,939,801 (Nëntëdhjetë million e nëntëqind e tridhjetë e nëntë mijë e tetëqind e një) lekë pa t.v.sh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” te ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Klos**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

a. Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit, sipas Shtojces 8

b. Sigurimin e Ofertes.

2. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2 Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopjet e çertifikuara të bilanceve për vitet **2022, 2023, 2024**, të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Keto bilance të jenë të konfirmuara nga ky autoritet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe Nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar Nenit 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore” përcaktohet se : “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”. Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009:

“Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i)totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet te paraqese vertetim nga administrata tatimore, për xhiron vjetore për vitet financiare **2022, 2023, 2024**, ku vlera e xhiros mesatare duhet të mos jetë më e vogël se vlera e fondit limit të tenderit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2 dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1 dhe pika 2) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitetin financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.*

2.2.3 Operatori ekonomik duhet paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitetet për vitin 2025 (këstet e maturuara). (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar). Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”.*

2.3 Kapaciteti Teknik:

Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale përsa i përket aftësisë teknike e profesionale

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **40%** e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesmarje në bashkim, vendosin me marveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të permbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.3.1/1 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular Vlerësimi për realizimin e punimeve shoqëruar me:
 - Kontrate Siperarrjeje
 - Situacion Perfundimtar
 - Aktin e Kolaudimit
 - Certifikate e marrjes në dorezim të perkohshme/te perhershme
 - Faturat Tatimore

- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Vertetim leshuar nga subjekti privat shoqëruar me:
 - Kontrate Siperarrjeje
 - Situacion Perfundimtar
 - Aktin e Kolaudimit
 - Faturat Tatimore

Shënim: Vertetimi duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.

2.3.1/2 Për kontratat e realizuara si bashkim operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kontratën e bashkëpunimit të operatorëve dhe prokurën e posaçme të deklaruara në fazën e tenderimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat..50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose minimalisht sa dyfishi i fondit limit, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Operatoret ekonomike duhet të paraqesë licensën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, "Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi".

	Licensa	Kategoria e kryerjes së punimeve
1	NP-1- A	Punime germimi ne toke
2	NP-5- A	Punime nentokesore, ura e vepra arti
3	NP-12- A	Punime te inxhinierise se mjedisit
4	NS-6- A	Sinjalistika rrugore jo ndricuese
5	NS-18- A	Punime topogjeodezike

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", si dhe Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, "Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, gjithashtu Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1-A	Punime germimi në tokë	Punime germimi ne trupin e rruges	0-20	977,300.93
NP-5-B	Punime nëntokësore, ura, vepra arti	Punime vepra arti (mure, kuneta, bordura, kanale dhe drenazhe)	0-20	1,170,656.91
NP-12-A	Punime inxhinierike mjedisore	Punime prishje, germimi dhe gjelberimi	0-20	150,000

NS-6-A	Sinjalistika rrugore jondriçuese	Sinjalistikë rrugore vertikale dhe horizontale	0-20	2,222,356.98
NS-18-A	Punime topogjeodezike	Matjet, piketimi, punimet ne trupin e rruges	0-20	100,000

2.3.3 Operatori ekonomik per realizimin e punimeve duhet te disponoje fuqi punetore minimalisht **52 (pesdhjet e dy)** persona.Per permbushjen e ketij kriteri, operatori ekonomik duhet te vetedkloroje disponimin e numrit minimal te punonjesve, per periudhen **Korrik 2025 – Shtator 2025**, ne formularin permbledhes te vetedeklarimit, sipas shtojces 8.Ndersa operatori ekonomik fitues, para lidhjes se kontrates, duhet te dorezoje dokumentacionin si me poshte:

a. Vertetim te leshuar nga Sigurimet Shoqerore ose Administrata Tatimore sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqim ku te specifikohet numri i punonjesve per secilin muaj, per periudhen **Korrik 2025 – Shtator 2025**

b. Listepagesat e punonjesve sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen **Korrik 2025 – Shtator 2025**

Argumentim: Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës dhe pagën minimale të lejuar, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje **Korrik 2025 – Shtator 2025**, tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përse kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosija e kriterit për një punësim **te paktën 65 persona** duke përfshire dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Po t'i referohemi projektit, preventivit, relacionit, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike janë bazuar ne VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018).Bazuar ne kater elementet e struktures se kostos(material, puntori, makineri, transport) zeri fuqi puntore ze rreth 20% te kostos.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, **drejtues teknik në licencën e shoqërisë**, si më poshtë:

2 (dy) Inxhinier Ndertimi

1 (nje) Inxhinier Topograf

1 (nje) Inxhinier Mjedisi

1 (nje) Inxhinier Gjeolog

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.

Operatori fitues përpara lidhjes së kontratës duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm per inxhinieret e mesiperm:

Kontratë pune e vlefshme, diplomë dhe CV.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim, topograf, mjedisi, dhe gjeolog është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

2.3.5 Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

1 (nje) Inxhinier Ndertimi

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.

Operatori fitues përpara lidhjes së kontratës duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

Kontratë pune e vlefshme, diplomë , dhe CV.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Kërkesa per Inxhinier Ndertimi, është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë,

përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

2.3.6 Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe punonjes të specializuar/kualifikuar si me poshte:

- **1 (nje) Teknik Ndertimi**
- **1 (nje) Teknik Gjeodet**
- **3 (tre) Karpentiere**
- **5 (pese) Punetore Asfalti**
- **2 (dy) Betonues**
- **4 (katër) Eskavatoriste**
- **4 (kater) Automakiniste**
- **4 (kater) Buldozeriste**
- **6 (gjashte) Shoferë**

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.

Operatori fitues përpara lidhjes së kontratës duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

Per punetoret e ndertimit te paraqitet kontratë pune e vlefshme, diplomë/certifikate trajnimi, deshmi kualifikimi te sigurimit teknik (te vlefshme)

Per manovratorët te paraqitet kontrate pune e vlefshme, lejet e drejtimit per makinerite e renda sipas profesionit perkates, deshmi kualifikimi te sigurimit teknik (te vlefshme)

Per shoferet te paraqitet kontrate pune e vlefshme, lejet e drejtimit, deshmi kualifikimi te sigurimit teknik (te vlefshme)

Në rastin kur punonjësit Manovrator/shofere janë të kontraktuar (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listagesat e shoqërisë.

Për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën ne SPE me të dhënat si më poshtë :

Nr .	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr.Amzes/ diplomes/certifikates profesionale	nr.nipt dhe nr.licens e ne rast se subjekti eshte privat
1					
2					
etj					

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë

të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin e kualifikuar lidhjet ngushtesisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zerat e punimeve. Nevoja për teknikun e ndërtimit dhe teknikun gjeodet është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit duke konsideruar punimet dinamike që kryhen në ndërtim dhe në punimet topogjeodezike të përcaktuara në zerat e punimeve. Sipas zerave të punimeve, volumeve, relacionit dhe projektit lind nevoja e kërkesës së punonjësve karpentier, betonues dhe punonjës asfalti pasi janë të nevojshëm në kryerjen e zerave të betonimit, ndërtimeve, vendosjes së tabelave dhe guardrailsave dhe tabelave.

Sipas zerave të punimeve dhe volumeve të tyre, argumentojmë se është e nevojshme për shoferet e kamionit për shkak të volumit të lartë të transportit të materialeve të gërmimit dhe transportin e materialeve të shtresave, materialeve të tjera që duhen për mbarevajtjen e punimeve etj.

Zerat e preventivit gjithashtu kërkojnë që punimet perkatese të kryhen me makineri gërmimi, ngjeshjeje, dhe makinerive të transportit të lendeve si autobitumatrice, autobot, autobetoniere. Për këtë lind nevoja që të kërkojnë Eskavatoristet, Automakinistet dhe Buldozeristet

Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe **personelin e nevojshëm**, për të zbatuar kontratën.

Në lidhje me 1 (një) Teknik ndërtimi prezencë e tyre në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit si (punimet e gërmimit, punimet strukturore, punimet e shtresave, punimet hidraulike, punimet e tarracës etj.) me sukses. Kjo kërkesë përputhet me volumet e punimeve referuar analizës teknike të preventivit si dhe afateve kohore të përcaktuara në grafikun e punimeve.

Në lidhje me 1 (një) teknik topograf nisur nga shtrirja e madhe e objektit dhe referuar grafikut të punimeve ku puna do të organizohet paralelisht në disa fronte është e nevojshme prezencë e tyre në kantier për të garantuar autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve në kohë dhe në cilesi. Kjo kërkesë përputhet me volumet e punimeve referuar analizës teknike të preventivit si dhe afateve kohore të përcaktuara në grafikun e punimeve.

Në lidhje me kërkesën për 3 (tre) Karpentierë, kjo kërkesë përputhet me volumet e punimeve referuar analizës teknike të preventivit si dhe afateve kohore të përcaktuara në grafikun e punimeve, konkretisht realizimi i zerave të punimeve të kallëpeve të strukturave të betonit,

Në lidhje me kërkesën për 2 (dy) Betonues, kjo kërkesë përputhet me volumet e punimeve referuar analizës teknike të preventivit si dhe afateve kohore të përcaktuara në grafikun e punimeve, konkretisht realizimi i zerave të punimeve të shtresave të betonit, strukturave të betonit

Në lidhje me kërkesën për 5 (pese) Punetore Asfalti është përcaktuar në lidhje me preventivin e punimeve, projektin e zbatimit dhe volumet e larta të asfaltit në to dhe gjithashtu duke gjykuar edhe në shtrirjen e madhe të objektit

Duke marrë në konsideratë natyrën e punimeve; makineritë që do të kërkojnë për realizimin e punimeve (Shtojca 8) si dhe Preventivin e Punimeve shtron nevojën që Ofertuesit të kenë të punësuar Manovrator dhe kryesisht 4 (kater) Punonjës Manovratorë automakiniste, 4 (kater) Punonjës Manovratorë buldozeriste, 4 (kater) Punonjës Manovratorë eskavatoriste dhe 6 (gjashtë) Drejtues mjeti me qëllim realizimin e kontratës me sukses. Numri i këtyre punonjësve është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”.

Makineritë e rënda të ndërtimit dhe emërtimet bëhen sipas Dëshmive të Aftësive Profesionale (DAP), të cilat ndahen si më poshtë :

a) eskavator gjurmimi e ngarkimi dherash : të të gjitha llojeve si dhe fadromat e të gjitha llojeve (me goma dhe me zinxhirë), manovratorëve u jepet dëshmi për Eskavatorist;

b) buldozer gjurmimi, shtyrje, nivelimi e ngjeshje dherash apo shpim toke : të gjithë llojet e traktorëve me thikë (ruspë), ose që tërheqin skreper, grejder apo nivelues, rul vibrues, shtruese asfalto-betoni, skreperët, grejderët dhe niveluesit kur janë vetëlëvizës, të gjithë llojet e traktorëve, me pajisje shtesë për ngritjen e peshave, shpimin e puseve etj., manovratorëve u jepet dëshmi për Buldozerist.

c) automjete për përdorim të veçantë (APV) sipas pikës “g”, të nenit 54, të Kodit Rrugor, makineri ndërtimi mbi bazë automjeti : autovinça, autobetonierë, autopompa betoni, autobitumatriçe, autosonda, autotokmak, manovratorëve u jepet dëshmi për Automakinist.

2.3.7 Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe punonjes te specializuar/kualifikuar si me poshte:

- **1 (një)** punonjes i pajisur me certifikuar **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”** e cila te jete e leshuar nga shoqeri te akredituara ose nga organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise.
- **1 (një)** punonjes i pajisur me certifikuar **“Ekspert per ndihmen e pare dhe nderhyrjen ndaj emergjencave”** e cila te jete e leshuar nga shoqeri te akredituara ose nga organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise.

Kriteri konsiderohet i permbushur ne paraqitjen ne formularin e vetedeklarimit.Per punonjesin e mesiperm perpara lidhjes se kontrates, te paraqitet kontrata e punes, dhe diploma ose certifikata e kerkuar.

ARGUMENTIM: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”

Në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010 „Për sigurinë dhe shëndetin në punë“, sipas të cilit: „Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....“. Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, dy punonjësit te cilit duhet te jene te certifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangin apo parandalojnë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të realizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi. Bazuar dhe ne V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM Nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë

dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

Nisur nga funksioni i tij, objekti i parashikuar të ndërtohet duhet të plotësojë minimalisht standardet infrastrukturore në fuqi, kundrejt institucioneve të arsimit të lartë. Referuar VKM Nr. 418, datë 10.5.2017 “Për Standardet, Kriteret dhe Procedurat për Hapjen, Riorganizimin, Ndarjen, Bashkimin ose Mbylljen e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe të Degëve të tyre”, Pika 2.c.) Standarde dhe normativa për infrastrukturën e IAL-së, paragrafi d) Të gjitha objektet, që do të shërbejnë si institucione të arsimit të lartë, duhet të kenë të instaluar sistemin e mbrojtjes kundra zjarrit ose të jenë kompletuar (sipas normativave përkatëse) me mjetet e nevojshme për mbrojtjen kundra zjarrit si dhe sistemin e mbrojtjes kundër shkarkesave atmosferike. Projekti i zbatimit përmban të gjitha masat aktive dhe pasive të mbrojtjes nga zjarri, të paraqitura në materialet grafike të të gjithë projekteve, si dhe në prevetivin e punimeve, grafikun, relacionet dhe specifikimet teknike përkatëse. Masat për mbrojtjen nga zjarri përmbledhen në projektin e mbrojtjes nga zjarri. Zbatimi i saktë i të gjitha masave dhe punimeve për mbrojtjen nga zjarri është dmosdoshmëri dhe detyrim. Në mbështetje të Ligjit Nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, neni 39, pika 3, projektimi, ndërtimi, rikonstruksioni dhe vënia në përdorim e veprave dhe strukturave të ndryshme, ndërtesave, rrjetit rrugor, elektrik, ujësjellës-kanalizimeve, pyjeve e kullotave, zonat e mbrojtura etj., bëhen në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi. Referuar nenit 42 të po këtij ligji, moszbatimi i projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, në konstruksionet, objektet e ndërtimit, në ndërtesa të çdo lloji apo aktivitete që ushtrohen në to, ngarkon me përgjegjësi, sipas legjislacionit në fuqi, personat fizikë e juridikë që i kanë ato në pronësi ose në administrim.

2.3.8 Operatori Ekonomik, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Kamione veteshkarkues me kapacitet mbajtes min 27 Ton	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
2	Kamione veteshkarkues me kapacitet mbajtes min 25 Ton	Ne pronesi ose me qera	Cope	2
3	Kamione veteshkarkues me kapacitet mbajtes 10-15 Ton	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
4	Kamione veteshkarkues me kapacitet mbajtes 7 -10 Ton	Ne pronesi ose me qera	Cope	2
5	Kamion me vinc	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
6	Kamioncina me kapacitet 3.5-5 Ton	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
7	Fadrome me goma	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
8	Eskavator me goma	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
9	Minieskavator	Ne pronesi ose me qera	Cope	2
10	Dumper me peshe mbajttese min 10 ton (mjet teknologjik me targa)	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
11	Minifadrome (mjet teknologjik me targa)	Ne pronesi ose me qera	Cope	1

12	Rrul ngjeshes gome - cilinder min 18 Ton	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
13	Rrul ngjeshes gome - cilinder i dhembeluar min 18 Ton	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
14	Rrul ngjeshes gome - cilinder i dhembeluar min 15 ton	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
15	Rrul asfalti cilinder - cilinder asfalti min 8 ton	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
16	Rrul asfalti gome - cilinder min 6 - 8 ton	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
17	Rrul asfalti cilinder - cilinder 1-3 ton	Ne pronesi ose me qera	Cope	2
18	Rrul ngjeshes - cilinder i dhembeluar 1-3 ton	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
19	Buldozer	Ne pronesi ose me qera	Cope	2
20	Autobitumatrice	Ne pronesi ose me qera	Cope	2
21	Asfaltoshtuese	Ne pronesi ose me qera	Cope	2
22	Autobot Uji	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
23	Grejder (mjet teknologjik me targa)	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
24	Mixer Rrotullues per nivelimin e shtresave	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
25	Automjet vijezi (APV) me boje	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
26	Rimorkiator për transport mjetesh të rënda min 20 ton + Kokë Tërheqëse	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
27	Autobetoni vetengarkuese mbi 3.5 m3 (mjet teknologjik me targa)	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
28	Autobetoni	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
29	Autopompe betoni	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
30	Betoni	Ne pronesi ose me qera	Cope	2
31	Vibrator Betoni	Ne pronesi ose me qera	Cope	2
32	Paisje per shkulje dhe mbjellje pemesh pa i demtuar min d=60 cm.	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
33	Paisje për largimin e ujerave nëntoksore me sistem gjilpërthithëse (Sistemi Well Point i paisur me pompë thithëse, age, kolektor dhe aksesori bashkues) thithëse + tuba	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
34	Sonda për shpim horizontal per kalimin e linjave	Ne pronesi ose me qera	Cope	1

35	Pompë betoni stacionere ose e lëvizeshme	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
36	Tokmak për ngjeshje dheu (kompatator)	Ne pronesi ose me qera	Cope	2
37	Matrapik	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
38	GPS	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
39	Motogjenerator	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
40	Betoforma (armaturë, kallëp) dërrase	Ne pronesi ose me qera	m2	300
41	Nyje Inerte (e pajisur me leje mjedisore)	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
42	Fabrike Asfalti (e pajisur me leje mjedisore)	Ne pronesi ose me qera	Cope	1
43	Fabrike Betoni (e pajisur me leje mjedisore)	Ne pronesi ose me qera	Cope	1

Mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 Per miratimin e rregullores “Per sigurine ne kantier” i ndryshuar, si më poshtë vijon:

- **Kokore minimumi 52 copë**
- **Jeleke Fosforeshente minimumi 52 copë**
- **Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 5 copë**
- **Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 5 copë**
- **Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 10 copë**
- **Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 20 copë**

Kiteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.

Operatori fitues përpara lidhjes së kontratës duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë (mjetet me goma), kur janë në pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që verteton pronesinë e mjetit: - certifikaten e pronesisë; -leja e qarkullimit; -certifikaten e kontrollit teknik; siguracionin; leja e transportit që leshohet nga njesia vendore dhe fotot perkatese; Per mjetet që pajisen me certifikaten e transportit për lende të rrethueshme, të paraqitet certifikata perkatese shoqeruar me dokumentacionin që verteton pronesinë e mjetit: - certifikaten e pronesisë; -leja e qarkullimit; -certifikaten e kontrollit teknik; siguracionin, dhe fotot perkatese

b) Ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesipër, duhet të paraqitet edhe kontrata noteriale e qirase e cila duhet të përfshijë objektin perkates dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.

c) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

d) Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruara në procedurë të shpallura fitues nga operatori ekonomik.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015, "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre" (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018), specifikimet teknike të projektit, volumet e miratuara nga projektuesi.

Referuar preventivit të punimeve, për punimet e transportit të dheut të germuar, punimet e shtresave, punimet e mbushjeve, kërkojnë mjetet kamione veteshkarkues për realizimin e tyre. Për këto arsye janë kërkuar kamione veteshkarkues në kapacitet të ndryshëm

Sipas preventivit të punimeve, një pjesë e madhe e punimeve janë punime germimi dhe për këto janë kërkuar mjetet eskavator me goma dhe zinxhire, minieskavator, damper, fadrome, etj.

Sipas preventivit të punimeve, në objekt kërkohet të realizohen punime për rruget në objekt dhe për këto arsye janë kërkuar mjetet si më poshtë:

Rrula ngjeshes, autobot uji, eskavator asfaltoshtuese, autobitumatrice, mixer rrotullues.

Sipas preventivit të punimeve, në objekt do të behen punime betoni, punime kalleperie, dhe për këto arsye janë kërkuar autobetoniere, betoniere, vibratore betoni, autopompe betoni.

Referuar terrenit në objekt do të behen punime të ndryshme në lidhje me bimesinë dhe për këto është kërkuar Makineri për shkulje pemesh pa i demtuar

Referuar terrenit të objektit, kërkohet të kryhet largim ujërash, për shkak të terrenit afër perronjeve dhe për këto arsye është kërkuar Sistem Wellpoint

Referuar terrenit të objektit, kërkohet të kryhet spostim i linjes së ujesjellesit në rrugën e fshatit Fullqet dhe për këto arsye është kërkuar sonda për shpim horizontal në mënyrë që të kryhet spostimi i linjes perkatese pa penguar punimet rrugore.

Sipas preventivit të punimeve, për realizimin e punimeve të ndryshme në objekt, për punimet e tubave, hekurit, prishjeve, etj kërkojnë mjetet e tjera të kërkuara si Betoniere, Vibrator betoni, Tokmak ngjeshes, Matrapik, GPS, Motogjenerator etj

Për sigurinë në kantier dhe për punetoret, janë kërkuar jeleket, kokoret, fikeset e zjarrit dhe kompletet e ndihmes së shpejte.

2.3.9 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si më poshtë:

ISO 9001:2015 Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë

ISO 14001:2015 Sistemet e Menaxhimit Mjedisor

ISO 45001:2018 Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë

Të gjitha çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë çertifikatën e mësipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë.

Argumentimi: Kërkesat e mesiperme jane vendosur bazuar ne Nenin 79, pika 1 te Ligjit Nr. 162/2020, “Per prokurimin publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licensat e meposhtme :

III.2.B per “Grumbullim, dhe transportim i mbetjeve inerte dhe urbane jo te rrezikshme”.

III.2.A per “Sherbime ekspertize dhe /ose profesionale lidhur me ndikim ne mjedis”

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Ligji nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar dhe në VKM nr. 538 datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit dhe disa rregullimeve të tjera nënligjore të përbashkëta” të ndryshuar. Operatori ekonomik fitues gjatë fazës së zbatimit të punimeve duhet të raportojë pranë autoritetit kontraktor për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative të veprimtarisë, për këtë qëllim subjekti duhet të jetë i licencuar për vlerësimin e ndikimit në mjedis në përputhje me detyrimet ligjore që rrjedhin nga ky i fundit për raportimin pranë autoritetit kontraktues. Rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit janë detyrim ligjor për çdo subjekt tregtar person fizik apo juridik për parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes së mjedisit në punë dhe dokumentat përkatëse të operatoreve i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

2.11 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet Tabela Sinjalistike dhe Tombino sipas Preventivit. Per materialet e kerkuara OE duhet te paraqese katalogun/et ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen si dhe certifikatat e cilesise.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 8, si dhe”, në bazë të nenit 45, pika 1 të VKM–së Nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Kjo kërkesë është kërkuar që ti sigurojë Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshem Teknik dhe ploteson specifikimet e kerkuara nga projektuesit për zbatimin në cilësi të kontratës për këtë object sipas

standarteve te kerkuara ne specifikimet teknike. Për të krijuar bindjen e autoritetit kontraktor për aftësitë teknike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur të operatorëve ekonomik fitues potencialë dhe realizimin me sukses të kontratave, vlerëson se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizim nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/ distributor autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë pajisjet dhe mallrat e nevojshme në këtë procedurë prokurimi. Duke qenë se materialet e kerkuara prodhohen në mënyrë industriale, certifikimi nga prodhuesi mbi parametrat e tyre është i domosdoshëm. Ne menyre qe Autoriteti Kontraktor te verifikojë qe specifikimet teknike te paisjeve te propozuara nga operatorët ekonomik plotësojnë parametrat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike te përcaktuara në dokumentat e tenderit , duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si: certifikatë/deklaratë konfirmimit CE, certifikatat e cilesise ose raportet e testimit nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara ne Specifikimet teknike .Duke marrë shkas nga tipologjia e objektit të prokurimit dhe nga punime që parashikohen të realizohen në preventive si dhe per shkak te interesit te larte qe ka objekti duhet të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira europiane. Prandaj e gjykojme të domosdoshme të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve europiane, OE ka aftësi të mjaftueshme për të realizuar me sukses dhe cilësi kontratën,duke furnizuar brenda kohës së përcaktuar vetëm pajisje origjinale me garanci, si dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për të bërë krahasueshmërinë e materialeve të ofruara nga operatori me ato të kërkuara në dokumentat e tenderit. Për të siguruar këtë gjë, por njëkohesisht dhe për të detyruar ofertuesit e mundshëm në zbatimin e këtyre standarteve AK ka parashikuar kërkesen e mësipërme vetëm për disa nga mallrat kryesorë me që do të përdoren në këtë objekt konkretisht OE duhet të japin dhe paraqesin ne menyre te detajuar karakteristikat teknike të mallarave të përfshirë në dokumentat e tenderit, karakteristika këto që duhet të përputhen me specifikimet teknike të kërkuara nga projektuesi. Për këtë, ofertuesit duhet të deklarojnë produkte të pajisura me certifikatë konformiteti CE/certifikate cilesie etj. Me anë të venies ne dispozicion ne fazen e ofertimit dokumentat si autorizim-marreveshje angazhimi,skeda teknike,certifikata cilesie ,certifikata konformiteti,raporte testimi ofertuesi garanton Autoritetin Kontraktor se mallrat që do të furnizojë do të jenë prodhim sipas kerkesave te projektit. Kërkesa për dorëzimin e formatit të autorizimit të prodhuesit dhe katalogëve për produktet e sipërcituara është një kërkesë në përputhje dhe proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës dhe se i shërben qëllimit të autoritetit kontraktor, nuk krijon pengesa të dukshme ose të fshehura për ofertuesit si edhe nuk diskriminon midis operatorëve ekonomikë vendas dhe të huaj, pasi standardet e kërkuara jane te harmonizuar me Standardin European

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Te gjitha dokumentet duhet te jene origjinale ose kopje te noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes se nje dokumenti, ose dokumente false dhe te pasakta, konsiderohen kushte per skualifikim.

Specifikime teknike, projekti, preventivi, grafiku dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në DT, me të dhenat e meposhteme:

Dokumentat e tenderit me kërkesat si më sipër firmosen nga anëtarët e njësisë së prokurimit, pas miratimit te gjithe anetaret e njesise kane akses (autorizohen) për botimin e tyre në rrugë elektronike pranë APP(www.app.gov.al).